




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave



V E N D I M

Nr. 1055, datë 29.7.2009

PËR

LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "LOGOS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Licencimin e shkollës së lartë private "Logos", e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.
2. Shkolla e lartë private "Logos" do të organizohet në dy fakultete:
 - a) Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, me programin e studimit, të ciklit të parë, "Informatikë e zbatuar", në formën e studimeve me kohë të plotë.
 - b) Fakultetin Ekonomik, me programin e studimit, të ciklit të parë, "Menaxhim turizmi", në formën e studimeve, me kohë të plotë.
3. Shkolla e lartë private "Logos" do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike, me plotësimin, së paku, të 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në:
 - a) "Informatikë e zbatuar";
 - b) "Menaxhim turizmi".

4. Ngarkohet shkolla e lartë private “Logos”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.
5. Shkolla e lartë private “Logos” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuarra, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
7. Shkolla e lartë private “Logos” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI



SALI BERISHA

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

MYQEREM TAFAL



NR.PROT.2379/5
DATË 28.10.2009

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA
Sekretari i Përgjithshëm




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

5079
Nr. ... Prot.

Tiranë, më *02.08.2010*

URDHËR

Nr. *396*, datë *02.08.2010*

PËR

**LEJIMIN PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE NË PËRPTHJE ME
LICENSËN E DHËNË PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "LOGOS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr. 1055 datë 29.07.2009 "Për Licencimin e Shkollës së lartë Private "Logos" dhe të propozimit të Komisionit të Veçante për Shqyrtimin e Kërkesave për Fillimin e veprimtarisë të institucioneve private të arsimit të lartë, i krijuar me Urdhrin nr. 193, datë 05.04.2010 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, "Për ngritjen e Komisionit të Veçantë për shqyrtimin e kërkesave për fillimin e veprimtarisë të institucioneve private të arsimit të lartë":

URDHËROJ:

1. Lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike të Shkollës së Lartë Private "Logos", në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1055 datë 29.07.2009 "Për Licencimin e Shkollës së Lartë Logos", për programet e studimit si më poshtë:
 - a) "Informatikë e zbatuar";
 - b) "Menaxhim turizmi".
- 2) Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe Shkolla e Lartë Private "Logos".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MYQËREM TAFAJ

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI



Nr. 2309. Prot.

Tiranë, më 06. 3. 2017

URDHËR

Nr. 93, datë 06. 3. 2017

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT TË KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Kolegjit Universitar "LOGOS", propozuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 5, datë 02.02.2017, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (29 faqe).
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera të Kolegjit Universitar "LOGOS", të miratohen në zbatim të Statutit të Kolegjit Universitar "LOGOS" dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Kolegji Universitar "LOGOS" brenda vitit akademik 2017-2018 të paraqesë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të gjitha aktet dhe dokumentacionin ligjor për organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, sipas përcaktimeve të këtij statuti.
4. Ndryshimet në statutin e Kolegjit Universitar "LOGOS", miratohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.
5. Statuti i Shkollës Private të Arsimit të Lartë "Logos" miratuar me shkresën nr. 1289/13 prot., datë 20.07.2011, shfuqizohet.
6. Statuti i Kolegjit Universitar "LOGOS", hyn në fuqi, pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës, Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Kolegji Universitar "LOGOS".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

Nr. 39 Prot.

Tiranë, më 06.01.....2011

URDHËR

Nr. 1, datë 06.01.2011

PËR

**HAPJEN E E PROGRAMEVE TË REJA, PRANË SHKOLLËS SË LARTË
PRIVATE "LOGOS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjet Nr. 9832, datë 12.11.2007 dhe Nr. 10307, datë 22.7.2010, dhe VKM Nr 1055, datë 29.07.2006 "Për licencimin e Shkollës së Lartë Private "LOGOS"

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Shkollës së Lartë private "LOGOS" të programeve të reja të studimit të Ciklit të Parë, në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë universitare "Bachelor" në:
 - a) Financë - Kontabilitet;
 - b) Menaxhim Biznes;
 - c) Teknik i Lartë Laboratorësh Mjekësor;të cilët realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë.
2. Shkolla e Lartë Private "LOGOS" Tiranë, të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Urdhri, pasi të ketë

marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

3. Ky institucion duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Privat dhe Shkolla e Lartë Private "LOGOS"

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJ


MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

4078/1
Nr. ... Fot.

Tiranë, më 16.8.2013

URDHËR

Nr. 335, datë 16.08.2013

PËR
HAPJEN E PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE MASTER
PROFESIONAL NË "FINANCË KONTABILITET" DHE "TEKNIK I LARTË
LABORATORËSH MJEKËSORË" NË SHKOLLËN E LARTË PRIVATE "LOGOS"
TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 44/1 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe vendimit nr. 1055, datë 29.07.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin Shkollës së Lartë Private "Logos"

URDHËROJ:

1. Hapjen, në institucionin privat të arsimit të lartë, ShLP "Logos", të programeve të ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në: "Financë Kontabilitet", dhe "Teknik i lartë laboratorësh mjekësorë", në përputhje me vendimin nr. 524, datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Programet e studimit Master Profesional në "Financë Kontabilitet", dhe "Teknik i lartë laboratorësh mjekësorë", përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, realizohen me 60-90 kredite, me kohëzgjatje normale 1.5 (një vit e gjashtë muaj) vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare Master Profesional në programet përkatëse.
3. Programet e studimeve, të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, të fillojnë veprimtarinë në vitin akademik 2013-2014.

4. Institucioni privat i arsimit të lartë ShLP "Logos", t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit, Drejtorja e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe institucioni privat i arsimit të lartë ShLP "Logos".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ

MINISTËR

Në mungesë dhe

ZËVENDËSMINISTRI

Talit Hajri

[Signature]



dt. 25/09/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI



Nr. 893... Prot.

Tiranë, më 22.09.2017

URDHËR

Nr. 428, datë 22.09.2017

**PËR
RIORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, "MASTER
PROFESIONAL" NË "FINANCË-KONTABILITET" DHE "TEKNIKË E LARTË NË
LABORATORË MJEKËSORË", NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "LOGOS"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 35, pika 1 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Financë Kontabilitet" në Fakultetin Ekonomik, të Kolegjit Universitar "Logos", Tiranë, nga 90 kredite të realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet", në Fakultetin Ekonomik, të Kolegjin Universitar "Logos", Tiranë.
2. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë" në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, të Kolegjit Universitar "Logos", Tiranë, nga 90 kredite të realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademike (2 semestra), në përfundim të të cilëve lëshohet diplomë "Master Profesional" në "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë", në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara, në Kolegjin Universitar "Logos", Tiranë.
3. Veprimtaria akademike për programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Financë-Kontabilitet" dhe "Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë", fillon në vitin akademik 2017-2018.
4. Kolegji Universitar "Logos", t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këto programe studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar "Logos".

Ky Urdhër lryn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA MËKOLLA

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

2635 Prot.
126

Tiranë, më 06/06/2013

URDHËR

Nr. 231 datë 06.6.2013

PËR

**HAPJEN DHE FILLIMIN E VEPRIMTARISË AKADEMIKE TË PROGRAMIT TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCËVE" NË "ADMINISTRIM
BIZNESI" TË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "LOGOS", TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe neneve 26/1, 44/1, 45/1 gërma "b" të ligjit nr. 9741, datë 21. 05. 2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen pranë Fakultetit Ekonomik të shkollës së lartë private "Logos", Tiranë, të programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Administrim biznesi" në bashkëpunim akademik me Universitetin e Pireut, Greqi.
2. Programi i studimit i përmendur në pikën 1 të këtij Urdhri drejtohet nga Universiteti i Pireut, Greqi, përmes ofrimit të kurrikulave të hartuara dhe stafit akademik të angazhuar prej tij. Shkolla e lartë private "Logos", Tiranë, do të kujdeset për infrastrukturën fizike dhe aspektet logjistike në dispozicion të programit të studimit.
3. Programi i studimit realizohet me 120 kredite, me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike, në formën e studimit me kohë të plotë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në "Administrim biznesi".
4. Ky program studimi hapet sipas Vendimit nr. 466, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
5. Shkolla e lartë private "Logos", duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
6. Programi i studimit fillon në vitin akademik 2013 - 2014.
7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe zbatimin e këtij urdhri; -
8. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit të Lartë, Drejtorja për Zhvillimin e Arsimit Jopublik, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, Këshilli i Akreditimit të Arsimit të Lartë si dhe shkolla e lartë private "Logos", Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ


MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 3550 Prot.

Tiranë, më 13.07. 2018

URDHËR

Nr. 408, datë 13.07.2018

PËR



HAPJEN E NJËSISË KRYESORE “FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE DHE KOMUNIKIMIT GJUHËSOR” NË KOLEGJIN UNIVERSITAR “LOGOS”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të nenit 30, pika 5 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit nr. 418, datë 10.05.2017 të Këshillit të Ministrave “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”,

URDHËROJ:

- Hapjen e njësisë kryesore në Kolegjin Universitar “Logos”, me përbërjen si më poshtë:
 - Departamenti “Gjuhë dhe Civilizim Grek”.
 - Departamenti “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”.
 - Departamenti “Studime në Teologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze”.
- Veprimtaria akademike në njësinë kryesore “Fakulteti i Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor” të Kolegjit Universitar “Logos”, fillon në vitin akademik 2018-2019.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
- Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Kolegji Universitar “Logos”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Lindita NIKOLLA




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 9318 Prot.

Tiranë, më 20.04. 2018

URDHËR

Nr. 192, datë 20.04.2018

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, "BACHELOR" NË
"STUDIME NË THEOLOGJINË SOCIALE DHE SHKENCAT RELIGJIOZE", TË
KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 35 dhe 75 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 41, datë 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë në "Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze" të Kolegjit Universitar "Logos", që realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 (tre) vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Bachelor" në "Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze" Fakulteti i Shkencave Humane dhe i Komunikimit Gjuhësor, Kolegji Universitar "Logos", që i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Ky program studimi hapet në bazë të Vendimit nr. 05, datë 02.02.2018 të Bordit të Akreditimit.
3. Veprimtaria akademike për programin e studimit "Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze" fillon në vitin akademik 2018-2019.
4. Programi i studimit "Studime në Theologjinë Sociale dhe Shkencat Religjioze" t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar "Logos".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7912 Prot.

Tiranë, më 20.02. 2018

URDHËR

Nr. 433, datë 20.07 2018

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, "BACHELOR"
NË "GJUHË DHE CIVILIZIM GREK", TË KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 35 dhe 73 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 41, datë 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë dhe civilizim grek", që realizohet me 180 kredite, në gjuhën greke, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Bachelor" në "Gjuhë dhe civilizim grek", që i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar "Logos".
2. Ky program studimi hapet në bazë të Vendimit nr. 17, datë 11.05.2018 të Bordit të Akreditimit.
3. Veprimtaria akademike për programin e studimit "Bachelor" në "Gjuhë dhe civilizim grek", fillon në vitin akademik 2018-2019.
4. Programi i studimit "Bachelor" në "Gjuhë dhe civilizim grek", t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar "Logos".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7911 Prot.

Tiranë, më 20.07. 2018

URDHËR

Nr. 432 datë 20.07 2018

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, "BACHELOR"
NË "MËSUESI PËR ARSIMIN PARASHKOLOR", TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR "LOGOS"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 35 dhe 73 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit nr. 41, datë 24.1.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë",

URDHËROJ:


1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin parashkollor", që realizohet me 180 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin parashkollor", që i përket nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitetin "Logos".
2. Ky program studimi hapet në bazë të Vendimit nr. 18, datë 11.05.2018 të Bordit të Akreditimit
3. Veprimtaria akademike për programin e studimit "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin parashkollor" fillon në vitin akademik 2018-2019.
4. Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për arsimin parashkollor" t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit

dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve
Arsimore dhe Kolegji Universitar "Logos".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



nr. 142 dt. 30-07-19



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 7479 Prot.

Tiranë, më 25. 7. 2019

URDHËR

Nr. 405, DATË 25. 7. 2019

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË
"AGROBIZNES" ME PROFILE "MARKETING I PRODUKTIT BUJQËSOR" DHE
"MENAXHIM I FERMËS BUJQËSORE" NË KOLEGJIN UNIVERSITAR
"LOGOS"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 20, 35, 69 dhe 72 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore", në Kolegjin Universitar "Logos", që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore", referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në "Agrobiznes" me profile "Marketing i Produktit Bujqësor" dhe "Menaxhim i Fermës Bujqësore", fillon në vitin akademik 2019-2020.
3. Programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe

Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve
Arsimore dhe Kolegji Universitar “Logos”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

BESA SHAHINI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4504 / Prot. 13

Tiranë, më 26.7. 2022

URDHËR

Nr. 455, Datë 26.7.2022

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR” NË
“PUNË SOCIALE”, NË KOLEGJIN UNIVERSITAR “LOGOS”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Punë Sociale”, me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Punë Sociale”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar “Logos”, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Punë Sociale”, në Kolegjin Universitar “Logos”, fillon në vitin akademik 2022-2023.
3. Kolegji Universitar “Logos”, të përmbushë rekomandimet e ekspertëve, para fillimit të vitit akademik 2022-2023, si më poshtë:
 - a) Të rritet numri i personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të specializuar në fushën e punës sociale.
 - b) Një pjesë e konsiderueshme e lëndëve të kategorisë B të ofrohen nga personel akademik që ka kualifikim në fushën e punës sociale, si dhe të përmirësohet përmbajtja e syllabuseve të tyre.
 - c) Të përmirësohet literatura bazë e lëndëve në përputhje me emërtimin dhe përmbajtjen e lëndëve.
 - d) Të detajohen termat e orëve të praktikës dhe laboratorëve në syllabuset ku janë parashikuar orë praktike dhe laboratorike, duke rritur orët e praktikës profesionale.
4. Kolegji Universitar “Logos”, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Kolegji Universitar “Logos”, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Logos”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 2416 / Prot. 15

Tiranë, më 4.10. 2022

URDHËR

Nr. 596, Datë 4.10.2022

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, MASTER I SHKENCAVE NË “PËRKTHIM PROFESIONAL”, NË KOLEGJIN UNIVERSITAR “LOGOS”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Përkthim Profesional”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe dhe angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Përkthim Profesional”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar “Logos”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit, të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Përkthim Profesional”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar “Logos”, fillon në vitin akademik 2022-2023.
3. Kolegji Universitar “Logos”, të përmbushë rekomandimet e ekspertëve të jashtëm, para fillimit të vitit akademik 2022-2023, në lidhje me:
 - a) Qartësimin e gjuhës së studimeve, pasi ka mospërputhje në lidhje me gjuhën greke, nëse është gjuhë me zgjedhje apo e detyrueshme.
 - b) Nivelin e gjuhës greke, nuk mund të jetë B1, pasi B1 nuk është nivel për studime përkthimore në Master. Gjithashtu rekomandohet nivel më i lartë se B2 edhe për gjuhën angleze.
4. Kolegji Universitar “Logos”, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

5. Kolegji Universitar “Logos”, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Logos”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË
PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË

Nr. 4920/2 Prot.

Tiranë, më 23.9. 2021

Lënda: Dërgohet urdhër për njohje dhe zbatim

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS" ✓

Adresa: Pallati i Sportit "Asllan Rusi", Rr "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si vijon:

1. Urdhër nr. 374, datë 23/9 /2021 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Turizëm Religjioz" në Kolegjin Universitar "Logos".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Alqi KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4920/11 Prot.

Tiranë, më 23.9, 2021

URDHËR

Nr. 374, Datë 23.9.2021

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË “TURIZËM RELIGJIOZ”, NË KOLEGJIN UNIVERSITAR “LOGOS”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Turizëm Religjioz” me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe dhe angleze, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Turizëm Religjioz”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar “Logos”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Turizëm Religjioz”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar “Logos”, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Kolegji Universitar “Logos” të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kolegji Universitar “Logos” të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Koleji Universitar "Logos".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Kolegji Universitar "LOGOS"
Nr. 6914 Prot.
Datë 717/2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 4235 Prot.

Tiranë, më 05.7.2023

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim.

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS" ✓

Pallati i Sportit "Asllan Rusi", Rruga "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit si më poshtë:

1. Urdhër nr. 333, datë 04.07.2023, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë-Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi", në Kolegjin Universitar "Logos".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Kolegji Universitar "LOGOS"

Nr. 6913 Prot.

Datë 717 / 12023

Nr. 4235 Prot.

Tiranë, më 04.04. 2023

URDHËR

Nr. 333 Datë 04.04.2023

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË
"GJUHË-LETËRSI ANGLEZE DHE TEKNOLOGJI PËRKTHIMI", NË KOLEGJIN
UNIVERSITAR "LOGOS"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë - Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi" me 180 kredite dhe kohëzgjatje 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë "Bachelor" në "Gjuhë - Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi", në Fakultetin e Shkencave Humane dhe të Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar "Logos", referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Gjuhë - Letërsi Angleze dhe Teknologji Përkthimi", në Kolegjin Universitar "Logos", fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Kolegji Universitar "Logos", të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kolegji Universitar "Logos", të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Logos”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 5122 / Prot. 2

Tiranë, më 15.8: 2023

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS" ✓

Adresa: Pallati i Sporteve "Asllan Rusi", Rr. "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort, Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 455, datë 14.08.2023, "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" në "Theologjia Sociale dhe Praktike" në Kolegjin Universitar "Logos".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5122/Prot.

Tiranë, më 14.8. 2023

URDHËR

Nr. 455, Datë 14.8.2023

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER
PROFESIONAL NË “THEOLOGJIA SOCIALE DHE PRAKTIKE”, NË KOLEGJIN
UNIVERSITAR “LOGOS”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike”, me 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit akademik (2 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Komunikimit Gjuhësor, në Kolegjin Universitar “Logos”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Theologjia Sociale dhe Praktike”, në Kolegjin Universitar “Logos”, fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Kolegji Universitar “Logos”, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kolegji Universitar “Logos”, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Logos”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

